

ZOGAJ

Vetëm 12 km larg qendrës së qytetit të Shkodrës, rrëzë malit të Taraboshit, në brigjet e liqenit të Shkodrës, shtrihet Zogaj, e përfshirë në vijën e verdhë të qytetit. Ajo vjen menjëherë pas Shirokës dhe bashkë me të janë ndër plazhet më të bukura të veriut. Zogaj ka një sipërfaqe prej 842620 metër katror bashkë me bregun pranë pjesës së liqenit që ndodhet aty. Ndërsa Shiroka është shfrytëzuar së tepërmi para viteve 90-të, Zogaj u frekuentua pas këtyre viteve, pasi më parë ishte zonë kufitare dhe nuk shkonin dot pushues. Aktualisht, Shiroka shfrytëzohet si pikë ndaluese dhe më pak si plazh, ndërsa më i frekuentuari është plazhi i Zogajt. Këtu ndodhen mbi 100 shtëpi me rreth 500 banorë. Ato janë shtëpi me shkallë te gurta në hyrje të oborreve e të banesave, me rrethim guri, kryesisht dykatëshe. Në stinën e verës shtëpitë vihen në dispozicion të pushuesve.

RRUGA PËR NË ZOGAJ

Për të shkuar në Zogaj kalon urën e Bunës, kthehesh djathtas dhe udhëton në rrugën rrëzë Taraboshit e cila të con fillimisht në Shirokë e pastaj në Zogaj. Rruga nga Shiroka deri në Zogaj është e ngushtë, por lokalet e shumta buzë liqenit, një pjesë e të cilëve me shkallë që zbresin nga rruga, kanë bërë zgjerime të pjesshme dhe vende parkimi për makinat. Rruga e ngushtë njekalimeshe krijon një problem akoma më të madh sidomos për lëvizjen e autobusëve me turistë të cilët mbërrijnë deri në Shirokë dhe e kanë të vështirë të lëvizin më tej drejt Zogajve vetëm për shkak të mungesës së infrastrukturës së duhur.

NATYRA

Një ndër plazhet e preferuara jo vetëm për shkodranët, Zogaj ka një plazh të mrekullueshëm që laget nga uji i liqenit të Shkodrës. Relievi i ulët kodrinor, prania e mjaft gjireve të vegjël shkëmbor, plazhet me zhavorr e gjelbërim, klima shumë e shëndetshme e ndikuar nga prania e liqenit dhe malit, e bëjnë Zogajn një plazh të pëlqyeshëm. Plazhi i Zogajt ka filluar të frekuentohet pas viteve '90, pasi më përpara aty ishte zone kufitare dhe ishte e ndaluar. Plazhi i Zogajt, duke qenë më pak i shfrytëzuar, afron mjedise deri diku të virgjëra dhe të pëlqyeshme.

Klima

Pozita gjeografike e zonës turistike të Zogajt pranë shpatit të Taraboshit dhe të liqenit të Shkodrës ndikojnë në formimin e mikroklimeve. Duke qenë buzë liqenit të Shkodrës përveç dritës direkte përfiton edhe nga reflektimi i thyerjes së dritës në sipërfaqen e ujit dhe asaj që thyhet nga shpatet e maleve. Sasia e reshjeve mesatare vjetore është rreth 1800 mm, temperaturat maksimale të ajrit janë 40°C dhe të ujit 27°C

Flora dhe Fauna

Në zonën turistike të Zogajt jetojnë në harmoni shumë lloje bimësh, peshqish, shpendësh dhe kafshësh. Ka mjaft lloje bimësh subendemike në formë shkurresh. Gjithashtu dallohet

për pasurinë e bimëve medicinale si trumëza, balsami, kina e verdhë dhe e kuqë e sidomos është e pasur me sherbelë me të cilën është e veshur pjesa më e madhe e malit të Taraboshit.

Për sa i takon faunës si ajo tokësore ashtu dhe ajo ujore është e pasur. Ndër llojet e kafshëve që gjenden këtu dhe që shrytëzohen për gjueti janë derri i egër dhe lepuri. Gjithashtu takohet ujku, dhelpra dhe një sërë kafshësh zvarranike.

Pjesa më e madhe e faunës përbëhet nga shpendët. Numërohen gjithsej 240 lloje shpendësh. Tipike dhe shumë të bukura këtu janë pulëbardhat. Ndër shpendët që shfrytëzohen për gjueti janë: rosat e egra, shapkat, karabullakët, patat e egra, fllanzat etj. Për të apasionuarit e peshkimit fauna ujore ofron rreth 65 lloje peshqish. Përmendim këtu: krapi, ngjala, karasi, kubla, qefulli, gjunca, skorta etj

Kjo pasuri e faunës dhe florës, e bën këtë zonë një ekosistem shumë të veçantë dhe atraktiv.

VLERA ARKITEKTURORE

Zona e Zogajve përveç bukurive natyrore ka bukuri të rralla arkitekturore si asnjë zonë tjetër në rajonin e Shkodrës. Shtëpitë janë shumë të veçanta, të veshura me gurë, ato më të vjetrat janë tre katëshe dhe janë quajtur kulla, me puse të thella me ujë të ftohtë. Rrugicat që gjarpërojnë nga lart të ndërtuara me kalldrëm prej guri ia shtojnë hijeshinë kësaj zone. Avantazhë për këtë destinacion turistik përbën fakti që janë bërë shumë pak ndërtime të reja me arkitektura të kohës së fundit, si rezultat i mos investimeve të shumta, çka ka ndikuar në ruajtjen e fizionomisë së tij origjinale.

TRADITA

Popullsia e zonës merret kryesisht me peshkim si një aktivitet që kjo zonë ka traditë të hershme gjë që lidhet me praninë e liqenit, me blegtori e pak bujqësi. Këtu ka mjaft dru frutore si fiq kumbulla, gështenja, mana me trungje të gjera të cilat qëndrojnë si dëshmitare të lashtësisë së kësaj zone shega, të cilat gjenden kudo gjatë rrugës dhe sidomos në pranverë lulet e tyre të kuqe i japin një hijeshi të veçantë duke krijuar një pamje unike. Drurë të tjerë frutorë të mbjellur bukur në formë brezaresh që ndodhen kryesisht në hyrje të zonës Zogaj që e bëjnë akoma më të bukur dhe vertetë unike këtë vend janë ullinjët. Banorët dallohen për përpunimin e tyre dhe nxjerrjen e vajit të ullirit.

Ato merren gjithashtu me prodhimin e mjaltit.

Traditë e zonës e cila vazhdon të ruhet edhe sot është punimi i qilimave artizanal.

Mjafton të shohësh motivet, harmonizimin e ngjyrave të qilimave për të zbuluar botën e pasur shpirtërore të zaganjorëve.

Përveç shijimit të veçantisë dhe bukurisë së produktit turistik të zonës së Zoges, turistët mund të vizitojnë atraksionet turistike zonat përreth afrojnë, të tilla si: burimin e ujit të ftohtë të quajtur çezme, kishën e Shën Rrokut e cila është e lidhur me festën e Shën Rrokut që festohet me 16 gusht, baret dhe restorantet e shumta.

AKTIVITETE

Llojit i turizmit që zhvillohet aktualisht në Zogaj është kryesisht turizëm familjar. Si rezultat i sasisë së madhe të shërbelës që gjendet në këtë zonë, Zogaj ka ajër të pastër e shumë kurativ që rekomandohet sidomos për fëmijët e vegjël azmatik dhe alergjik. Duke pasë parasysh pozitën gjeografike ofertën e pasur natyrore e kulturore, veçantinë arkitekturore, jetën e thjeshtë si të një fshati, kjo zonë ka potenciale për zhvillimin e disa lloje turizmi si ai balnear, agro-turizmi, turizëm kurativ, ai i interesit të veçantë . Përveç shijimit të veçantisë dhe bukurisë së produktit turistik të zonës së Zoges, turistët mund të vizitojnë atraksionet turistike zonat përreth afrojnë, të tilla si: burimin e ujit të ftohtë të quajtur çezme, kishën e Shën Rrokut e cila është e lidhur me festën e Shën Rrokut që festohet me 16 gusht ,baret dhe restorantet e shumta. E gjithë zona përben një ekosistem delikat dhe zhvillimi i një turizmi masiv do të sillte pasoja shumë negative për të ndaj zhvillimi i turizmit duhet të karakterizohet nga zhvillimi i qëndrueshëm.

AKOMODIMI

Në dispozicion të pushuesve janë shtëpitë e banorëve, që janë banesa tipike me shkallë të gurta, oborr të rrethuar dhe kryesisht me dy kate. Çmimet e dhomave në banesat private shkojnë deri 15.000 lekë për dy javë, ndërsa në hotelin e vetëm që ndodhet këtu çmimet janë 18.000 - 23.000 lekë në dy javë dhe dhomat i kanë pajisjet e kushtet e nevojshme.